



Prishtinë, 10 tetor 2011
Kodi i ZRRE-së: V_383_2011

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenit 6 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes,
4. Kërkesën e KEK SH.A të datës 13.04.2011 dhe kërkesës fillestare të datës 11.03.2010 për aprovimin e dokumentit **“Plani Zhvillimor KEK-Shpërndarjes 2010 – 2014”**,

në seancën e mbajtur me datë 30 shtator 2011, nxori këtë:

VENDIM

- I Aprovohet** dokumenti **“Plani Zhvillimor i KEK-Shpërndarjes 2010 – 2014”** si në Shtojcën e këtij vendimi.

Arsyetim

ZRrE me datë 13.04.2011 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit “Plani Zhvillimor i KEK-Shpërndarjes 2010 – 2014” të KEK SH.A. Dokumenti është analizuar, dhe në te janë përfshirë komentet e ZRrE-së në disa faza. Pas vlerësimit, dhe kërkesës së KEK-ut ZRrE aprovon dokumentin si në shtojcë të këtij vendimi.

Nga data e pranimit të këtij vendimi apo publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, KEK-u duhet të publikojë menjëherë në faqen e vet elektronike versionin e aprovuar të “Planit Zhvillimor të Shpërndarjes 2010 – 2014”.

- II.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar